

TLAS



Shërbimi Ligjor Falas Tiranë

Gazeta TLAS

Botim i Shërbimit Ligjor Falas Tiranë

Nr. 2 2009



Botimi i këtij materiali është mbështetur
financiarisht nga CAFOD UK

CAFOD
just one world

RAPORTI I STUDIMIT (MONITORIMIT)

1.1 Përmbledhje e gjetjeve mbi pyetësin "Vlerësim mbi zbatimin e ligjit "Për gjendjen civile", pas ndryshimeve të fundit të procedurave për regjistrimin e lindjeve"

Raporti i monitorimit paraqet një pasqyrë modeste të gjetjeve dhe rezultateve të vëzhgimeve të zhvilluara me punonjësit e zyrave të gjendjes civile në 4 rrethe kryesore të Shqipërisë (Tiranë, Elbasan, Durrës, Fier) për zbatimin e ndryshimeve të Ligjit Nr. 8950, datë 10. 10. 2002 dhe për nivelin e kënaqësisë së publikut në këto rrethe për shërbimet e ofruara nga punonjësit e zyrave të gjendjes civile. Ky vëzhgim u krye në periudhën Janar 2009 – Prill 2009.

Shqipëria vazhdon të jetë një vend me nivel të lartë lindshmërie të popullatës. Lindshmëria

vjetore në shkallë vendi është përafërsisht rreth 34300 lindje. Arsyet demografike por edhe ato ligjore e kanë vendosur në plan të parë rolin e zyrave të gjendjes civile për regjistrimin e shtetasve. Regjistrimi i lindjeve është një nga shërbimet më të rëndësishme që kryhen nga këto zyrat e gjendjes civile dhe nëpunësit e gjendjes civile.

Nga sondazhi rezultoi se pjesa më e madhe e punonjësive të zyrave të intervistuar (mbi 50 % e tyre) regjistrojnë mbi 100 lindje në vit secili. Me hyrjen në fuqi të ndryshimeve të Ligjit Nr 8950 dt.10.10.2002 "Për Gjendjen Civile" në 15 korrik 2008, është e ndjeshme rritja e kurbës së numrit të regjistrimit të lindjeve veçanërisht të atyre fëmijëve që kishin lindur në institucione shëndetësore por që rezultojnë të paregjistruar si pasojë e mos respektimit të afatit prej 45 ditësh për deklarimin e lindjes dhe si pasojë e pamundësisë për të paguar gjobën që parashikonte ligji i mëparshëm.

Grafiku i mëposhtëm ilustron këtë tendencë ku rezultojnë se 57.6 % e punonjësve të intervistuar pohojnë se numri total i lindjeve që ata regjistrojnë brenda 1 viti është mbi 100 lindje, 34.1% janë përgjigjur se regjistrojnë 50-100 lindje në vit, dhe 7.6 % regjistrojnë më pak se 50 lindje në vit.




Fig.1

Te ato zyra të gjendjes civile ku numri i regjistrimit ka qënë më i lartë se 100 lindje në vit, kup-tohet që ndryshimet e ligjit “Për gjendjen civile” kanë pasur më shumë efekt. Këtë e vërteton fakti që 91.7% e punonjësve të gjendjes civile të intervistuar janë përgjigjur se me hyrjen në fuqi të ligjit, edhe pse periodha e zgjedhur ishte vetëm 4 muaj,

Janar- Prill 2009, ata kanë regjistruar më shumë se mesatarja e krahasuar me të njëjten periudhë të vitit të mëparshëm, kur ndryshimet nuk ishin miratuar ende. Pra vetëm për 4 muaj mbas hyrjes në fuqi të ligjit secili nga të intervistuarit kishte regjistruar mbi 50 lindje sic shihet dhe në fig.2:




Fig.2

Zyrat e Gjendjes Civile mbajnë pjesën më të madhe të peshës përse i përket regjistrimit të lindjeve. Regjistrimi i lindjeve në gjendjen civile nuk është vetëm një detyrim ligjor për shtetasit por është kusht parësor për gëzimin e të drejtave dhe lirive personale, ekonomike, politike, shërbimet shëndetësore, arsimore.

Por sondazhi, duke ju referuar figurës nr. 3 më poshtë tregon se ende ka një numër të konsiderueshëm lindjesh që klasifikohen në më shumë se 30 raste në vit për çdo punonjës të gjendjes civile, të cilat si pasojë e problemeve ligjore duhet të regjistrohen vetëm me anë të procedurës gjyqësore. Edhe fakti që 56.5% e të intervistuarëve kanë pohuar se numrin e lindjeve me procedurë gjyqësore e kanë më pak se 30 evidenton pikërisht ekzistencën ende të rasteve që detyrimisht duhet të kryhen me procedura gjyqësore dhe që për shkak të mbartjes nga viti në vit përbën tashmë jo faktin e regjistrimit të një “fëmije” por regjistrimin e një të “rituri”.




Fig.3




Fig. 4

Arsyet kryesore të mosregjistrimit të lindjeve, të identifikuar nga të intervistuarit (punonjëset e gjendjes civile) dhe që janë pasqyruar në tabelën nr. 4 mund t'i klasifikojmë si më poshtë:

1. Rreth 48% e familjarëve të interesuar për regjistrimin e lindjes nuk e njohin ligjin dhe afatet ligjore të deklarimit. Kjo do të thotë se me heqjen e afatit të deklarimit për regjistrimin e lindjes në bazë të ndryshimit të miratuar dhe me heqjen e gjobës, numri i regjistrimit të lindjeve, përmes procedurave administrative pritet të rritet me 48 % për periudhën Korrik 2008-Korrik 2009.

2. Rreth 21.5% e familjarëve të paraqitur për regjistrimin e lindjes

në zyrat e gjendjes civile kanë pasaktësi në dokumentacionin e paraqitur. Nga eksperiencia e të intervistuarve¹, kjo do të thotë se nëna ka deklaruar identitet (emër ose mbiemër) të ndryshëm nga ai që zotëron, etj. Të gjitha këto përbëjnë potencialisht raste që nënkuptojnë detyrimisht zgjidhjen në rrugë administrative duke ju nënshtuar korrigjimit të dokumentave të mësipërme, ose në pamundësi të kësaj alternative, zgjidhjen me procedura gjyqësore.

Nga përvoja e punonjësve të gjendjes civile nuk rezulton refuzimi i regjistrimit të lindjes. Një nga problemet kryesore të evidentuara nga sondazhi është se një pjesë të konsiderueshme të qytetarëve që u është refuzuar regjistrimi nuk u është dhënë një përgjigje me shkrim nga ana e punonjësve të gjendjes civile, me shkaqet përkatëse të refu-

zimit. Ky është një tregues i mospajtimit të mirë të detyrimeve ligjore nga ana e punonjësve të gjendjes civile në lidhje me informimin e qytetarëve. Mangesi të tilla mund të bëhen edhe burim konfuzioni për qytetarët si dhe shkak për mbetjen të paregjistruar të fëmijëve për një kohë të gjatë pas lindjes së tyre.

Po t'i referohemi tabelës nr.5 më poshtë del se pyetjes nëse ka pasur raste të refuzimit të regjistrimit të lindjes nga ana e punonjësve të gjendjes civile, pjesa më e madhe e të intervistuarëve (rreth 89.4%) kanë deklaruar JO dhe vetëm 10.6 % kanë deklaruar PO.

Për ato raste që ka pasur refuzimi i regjistrimit të lindjes, jo të gjithë individëve i është dhënë përgjigje me shkrim më saktësisht vetëm 50% të individëve që i është refuzuar regjistrimi i lindjes i është kthyer përgjigje me shkrim. Punonjësit e gjendjes civile duhet t'i shoqëronin me një përgjigje të shkruar ku të theksohej mangësia dhe shkakun që pengonte realizimin e regjistrimit.

¹ Punonjësit e gjendjes civile që u bënë objekt i intervistimit, kanë qënë njëkohësisht edhe pjesëmarrës në trajnimet e organizuara me qëllim zbatimin korrekt të ndryshimeve që pësoi legjislacioni i Gjendjes Civile në lidhje me regjistrimin e lindjeve. Kjo bëri që shumë raste konkrete të diskutoheshin si "case study" dhe që do të përbënin argumentimin e mëtejshëm të problemeve që përfituesit paraqesin në shërbimin e gjendjes civile.




Fig 5

Rreth 63.4 % kanë deklaruar si arsye të refuzimit të regjistrimit të lindjes pasaktësinë e të dhënave në çertifikatën e asistencës në lindje, të lëshuar nga institucioni shëndetësor përkatës dhe 36.6% e punonjësve të gjendjes civile kanë deklaruar se lindjet kanë ndodhur jashtë institucionit shëndetësor. Kjo përqindje prej 36.6 % në raport me numrin e lindjeve në shkallë vendi² përbën një numër të konsiderueshëm që duhet në mënyrë të pashmangshme të trajtohet me rrugë të tjera ligjore dhe që sigurisht në kushtet e varfërisë që realisht jetojnë pjesa më e

² Po t'i referohemi statistikave të Ministrisë së Shëndetësisë, respektivisht për vitin 2007 dhe 2008 del se numri i përgjithshëm i lindjeve në shkallë vendi është përkatësisht 34383 dhe 33368 lindje në vit.

madhe e popullsisë e bën të domosdoshme nevojën e shërbimeve ligjore falas, në rast të kundërt rrezikon rritjen e numrit të personave të paregjistruar.




Fig 6

Lindjet e fëmijëve të ndodhura në shtete të huaja kanë rezultuar veçanërisht problematike për shkak të mospërputhjeve formale dhe procedurale të ligjit shqiptar me atë të vendit përkatës ku ka lindur fëmija. Por edhe mosnjohja e kërkesave të ligjit shqiptar nga qytetarët shqiptarë që jetojnë përkohësisht jashtë Shqipërisë, për plotësimin e procedurave të regjistrimit të lindjes në vendin ku ka ndodhur

lindja si dhe të formës që duhet të kenë dokumentat e shteteve të huaja për tu përdorur përpara organeve administrative shqiptare.




Fig. 7

Siç shikohet në tabelën e mësipërme, 60.3 % e të intervistuarëve deklarojnë se kanë refuzuar regjistrimin i lindjeve të fëmijëve jashtë shtetit, sepse ju mungon forma që kërkon ligji shqiptar për dokumentin që provon lindjen në shtetin e huaj». Kjo ka të bëjë me vështirësitë që hasin shtetasit shqiptarë që ndodhen në emigracion ilegal, për të siguruar procedurat që kërkon ligji për vlefshmërinë e një dokumenti zyrtar lëshuar nga

një shtet i huaj dhe veçanërisht me procedurat e legalizimit të tyre pranë ambasadave apo konsullatave përkatëse. Moshnjohja e këtyre procedurave nga individët dhe veçanërisht vështirësitë ekonomike të udhëtimit, vështirësitë e lëvizjes së lirë për t'ju shmangur kontroleve policore, kanë qënë dhe do të vazhdojnë të jenë shkaqet themelore të mosregjistrimit të lindjeve të shtetasve shqiptarë në një shtet të huaj.

1.2 Përmbledhjeve e gjetjeve mbi pyetësin "Matja e nivelit të kënaqësisë së publikut për shërbimet e ofruara nga Zyrat e Gjendjes Civile"

Në këtë raport paraqiten disa nga rezultatet kryesore të sondazhit të zhvilluara nga TLAS me qytetarë të cilët kishin kërkuar shërbim pranë zyrave të gjendjes civile, gjatë periudhës Janar – Prill 2009. Siç përmendet dhe më sipër sondazhi u krye në qytetet e Tiranës, Durrësit, Fierit dhe Elbasanit. Numri total i

qytetarëve të pyetur është 407, dhe të 407 pyetësorët e plotësuar rezultuan të vlefshëm.

Ky është sondazhi i parë mbas hyrjes në fuqi të ndryshimit të ligjit "Për gjendjen civile" për regjistrimin lindjeve dhe hapave të parë të aplikimit të informatizimit të shërbimit. Sondazhi synon të reflektojë qëllimin e TLAS në kuadër të projektit "Fuqizimi i komuniteteve vulnerabël për rritjen e aksesit në shërbimet ligjore", misionin që organizata ka për t'i ardhur në ndihmë njerëzve në nevojë si dhe forcimit të bashkëpunimit të organizatës me strukturat shtetërore dhe veçanërisht me zyrat e gjendjes civile në shkallë vendi.

Pritshmërinë në lidhje me frekuencën e lartë të kontaktit të publikut me këto zyra e reflekton edhe sondazhi ku 99.8 përqind e qytetarëve shprehën se kanë patur kontakt dhe kanë kërkuar shërbimin e zyrave të gjendjes civile.

a. Lloji i shërbimit

Zyrat e gjendjes civile ofrojnë një numër shërbimesh për publikun ku më të rëndësishmet janë:

- *Pajisja me certifikatë personale, familjare, martesë, etj.*
- *Regjistrimi i lindjeve.*
- *Procedurat që lidhen me shpalljen dhe lidhjen e martesës.*
- *Deklarimi i vdekjeve dhe çregjistrimi i personave të vdekur nga regjistri i gjendjes civile.*
- *Transferimi i të dhënave personale dhe familjare si pasojë e ndryshimit të vendbanimit të shtetasve.*

"Pajisja me certifikatë" është shërbimi kryesor për të cilin qytetarët u drejtohen zyrave të gjendjes civile". Kjo edhe për faktin se certifikata e lëshuar

nga zyrat e gjendjes civile është edhe dokumenti kryesor i identifikimit për shtetasit shqiptarë i kërkuar nga të gjitha institucionet publike dhe private të nevojshme për kryerjen e një numri të konsiderueshëm veprimesh si ato bankare, gjyqësore, noteriale, të punës, përkrahjes ekonomike etj. Për një pjesë të këtyre veprimeve, çertifikata personale kërkohet të jetë e lëshuar brenda një periudhe një deri në tre muajore, gjë që rrit edhe frekuencën e kërkesave nga ana e qytetarëve për t'u pajisur me një çertifikatë të përditësuar.




Fig. 1

Siç paraqitet edhe në grafikun nr. 1 mbi llojin e shërbimeve të kërkuar pranë zyrave të gjendjes civile, pjesa më e ma-

dhe e të intervistuarëve (70.4 %) kanë deklaruar që shërbimi më i shpeshtë është "për t'u pajisur me çertifikatë". Më pas renditen kërkesat për regjistrim lindjeje (12.0% e të intervistuarëve), lidhje martese (9.1 %), çregjistrim vdekjeje (5.2 %) dhe në fund transferim të dhënash nga një zyrë e gjendjes civile në tjetrën (3.3 %) dhe vetëm 6.0 % e të intervistuarëve kanë kërkuar shërbime të tjera.

b. Cilësia në ofrimin shërbimit

Cilësia është një komponent i rëndësishëm në vlerësimin e shërbimit. Vlen të theksohet se ajo lidhet në vetvete jo vetëm me komunikimin e punonjësve, shpejtësinë e ofrimit të shërbimit dhe infrastrukturën (kushtet fizike dhe mjediset që ofrojnë këto zyra) por mbi të gjitha konceptohet si një produkt final të cilin qytetari dëshiron ta marrë në fund brenda këtyre kushteve optimale. Përgjithësisht qytetarët rezultojnë të kënaqur kur arrijnë të marrin shërbimin e kërkuar dhe më pak kur nuk

arrijnë ta marrin atë apo u paraqiten pengesa (objektive apo subjektive qofshin këto).




Fig.2

Në pyetjet që lidhen me cilësinë e ofrimit të shërbimit nga punonjësit e gjendjes civile, të intervistuarit kanë pasur mendime të ndryshme. Pjesa më e madhe e të intervistuarëve janë shprehur pozitivisht në lidhje me cilësinë e shërbimit të gjendjes civile (65.7% e tyre shprehen se janë të kënaqur apo shumë të kënaqur nga shërbimi që u është ofruar). **Megjithatë është e rëndësishme të theksohet se 1/3 e qytetarëve shprehen të pakënaqur nga shërbimi.**

Siç paraqitet edhe në grafikun nr.2 32.2 % e të intervistuarëve kanë qënë « shumë të kënaqur », 33.4 % të kënaqur dhe 33.7% « të pakënaqur » ***gjë që tregon se perceptimi i të intervistuarëve mbi cilësinë e shërbimit është i një niveli relativisht të ulët.***

Dhe kjo gjë ndikohet nga komponentët si etika, shpejtësia në ofrimin e shërbimit dhe infrastruktura.

b.1 Etika në ofrimin e shërbimit

Koncepti i etikës lidhet ngushtë me cilësitë e komunikimit të punonjësve të gjendjes civile me publikun dhe ky i fundit është vlerësuar në dy komponentë atë të profesionalizmit (shërbim që ofrohet pa të meta dhe brenda kërkesave ligjore) dhe atë të mirësjelljes (komunikimi verbal dhe qëndrimi joverbal i kënaqshëm).




Fig. 3

Ndonëse pjesa më e madhe e qytetarëve e vlerësojnë pozitivisht komunikimin e punonjësve të gjendjes civile, **4 në 10 prej tyre** shprehen të pakënaqur në lidhje me shkallën e profesionalizmit (rreth 1/4 e të intervistuarve) dhe mirësjelljes (rreth 1/3 e të intervistuarve). Shkalla e vlerësimit pozitiv dhe negativ në lidhje me komunikimin lidhet ngushtë me vlerësimin pozitiv apo negativ në lidhje me cilësinë e shërbimit.




Fig. 4

Mbi etikën dhe profesionalizmin në ofrimin e shërbimit shihet se 60.4 % e tyre mendojnë se personeli i gjendjes civile komunikon në mënyrë « të sjellshme dhe profesionale », dhe vetëm 21.4 % i të intervistuarëve mendojnë se komunikimi i personelit nuk është as i sjellshëm dhe as profesional gjë që shpreh dhe faktin se ato janë të pakënaqur nga shërbimi i ofruar nga ky personel. (shih fig 4)

b.2 Shpejtësia në ofrimin e shërbimit

Shpejtësia në ofrimin e shërbimit është komponent i rëndësishëm që ndikon në cilësinë e shërbimit. Marja e shërbimit pa pengesa, brenda një kohe të përshtatshme, pa qenë i detyruar të paraqitesh më shumë se një herë, pa zvarritje të pajustificueshme ndikon ndjeshëm në kënaqësinë e qytetarëve dhe vlerësimin që ata kanë nga shërbimi i ofruar nga zyrat e gjendjes civile.

Perceptimi i kohës së pritjes për marrjen e një shërbimi është i lidhur me shumë aspekte subjektive pra jo vetëm me kohën reale dhe që lidhet edhe me përvojën e mëparshme por edhe domosdoshmërinë e marrjes së shërbimit (pjesa më e madhe e këtyre shërbimeve janë bazike për marrjen e shërbimeve të tjera por edhe të detyrueshme nga pikëpamja ligjore siç janë rastet e lidhjes së martesës, regjistrimi i lindjeve apo deklarimi i vdekjeve).

Rreth gjysmës së qytetarëve u është dashur më shumë se një orë në marrjen e shërbimit pranë zyrave të gjendjes civile, ndërsa rreth $\frac{1}{4}$ e tyre më shumë se dy orë.




Fig 5.

Kjo dëshmon se perceptimi që ka publiku mbi ofrimin e shërbimit është se për të përfituar shërbim pranë zyrave të gjendjes civile duhet të konsumosh një kohë. Dhe kjo është arsye që në ato zyra vonohesh për të marrë shërbim.

Për rrjedhojë në grafikun nr. 5, rreth 54.3% e të intervistuarëve kanë deklaruar se shërbimin e kërkuar nga zyrat e gjendjes civile e kanë marrë në “më pak se 1 orë”, 25.1% kanë deklaruar “më shumë se dy orë” dhe 19.9% “nga 1 deri në 2 orë”.





Fig. 6

Radhët e gjata dhe puna e ngadalë

Radhët e gjata paraqitet si vështirësia kryesore e qytetarëve për marrjen e shpejtë dhe pa

vonesa të shërbimit pranë zyrave të gjendjes civile. Ekzistenca e një numri të kufizuar sportesh dhe punonjësish nga njëra anë dhe një numri të lartë qytetarësh që kanë nevojë për këto shërbime ndikon negativisht në kohën e pritjes në radhë por edhe në pakënaqësinë e atyre që për ndonjë arsye nuk arrijnë ta marrin këtë shërbim.

Kështu të intervistuarit pohojnë se "radhët e gjata" (rreth 74.3% e të intervistuarve) janë arsye e vonesës në ofrimin e shërbimit ; (rreth 21.3% e të intervistuarve) deklarojnë si arsye punën e ngadaltë të personelit, dhe vetëm 4.3% e të intervistuarëve mendojnë se "kufizimi i orarit" përbën shkak për vonesë në ofrimin e shërbimit. (shih grafikun nr.5).



b.3 Infrastruktura e ofrimit të shërbimit

Kushtet e punës dhe mjediset e pritjes së publikut janë evidencuar si një pikë e dobët në lidhje me shërbimet e ofruara.

Kushtet jo të mira nga pikëpamja higjienike por edhe e pajisjes bëhen shkas për rritjen e pakënaqësisë nga njëra anë por edhe perceptimit të kohës së pritjes (koha e pritjes do të përballlohej më lehtë nëse kushtet do të mundësonin qëndrimin e ulur, pajisjen me bileta dhe numra për paraqitjen në radhë të qytetarëve, ajrosje të përshtatshme dhe ngrohje/aspirim, evitimin e agjentëve atmosferikë –shi, diell, i ftohtë etj).

Siç paraqitet edhe në grafikun nr. 7, kushtet apo infrastruktura evidentohen nga qytetarët si shkak tjetër që ndikon në cilësinë e ofrimit të shërbimit në gjendjen civile, ku nga pjesa më e madhe e të intervistuarëve vlerësohen si "jo të mira" (rreth 43.5 %).




Fig.7

Perceptimi i personave që kanë qënë të "pa kënaqur nga shërbimi i ofruar në zyrat e gjendjes civile" lidhet me kushtet se ku ofrohet ky shërbim. Kështu duke analizuar grafikun e fig.8 na rezultoi se rreth 83.2 % e personave të pakënaqur nga shërbimi i gjendjes civile (që përbënin 33.7 % e të gjithë të intervistuarëve) i kanë vlerësuar edhe kushtet e dhënies së shërbimeve si "jo të mira".




Fig.8

c. Sugjerime të publikut për përmirësimin e ofrimit të shërbimit

Në analizimin dhe interpretimin pyetjes së hapur drejtuar publikut se cilat janë sugjerimet e publikut mbi përmirësimin e shërbimit të gjendjes civile, u identifikuan tre fusha kryesore ku publiku mendon se ka nevojë të ndërhyet për të përmirësuar:

1. Mjedisi dhe infrastruktura janë konsideruar si fusha e parë që ka nevojë për përmirësim. Ky opinion reflekton me 52.3 % e qytetarëve të intervistuar. Pjesa më e madhe e mendimeve të

dhëna nga publiku lidhet me krijimin e mjediseve më të përshtatshme pune për personelin, duke shtuar sportelet e shërbimit për të shmangur rradhët e gjata, dhe krijimin e mjediseve komode për qytetarët që paraqiten për të marrë shërbim.

2. Aftësimi i personelit është fusha e dytë ku mendohet se ka nevojë për përmirësim. Rreth 45.7% e të intervistuarëve mendojnë se trajnimi i personelit është i domosdoshëm në rritjen me cilësisë e shërbimeve, por edhe rritja e numrit të personelit në ato zyra ku ka një ngarkesë shumë të madhe pune, do ta bënte shërbimin më të shpejtë. Përmirësimi i etikës në ofrimin e shërbimit, ku të intervistuarit sugjerojnë më shumë mirësjellje gjatë ofrimit të shërbimit.

3. Pagimi i taksave si detyrim për tu pajisur me çertifikatë 1.9% e të intervistuarëve mendojnë se detyrimi për të paguar taksat është një pengesë mjaft e madhe në marrjen e shërbimit nga gjendja civile, dhe për këtë

arsye ato sugjerojnë heqjen e këtij detyrimi. (shih fig.9)




Fig. 9



REKOMANDIME

Si rezultat i gjetjeve të identifikuar nga sondazhet kemi radhitur disa rekomandime të cilat mendojmë se mund të vlejné në përmirësimin e shërbimit të gjendjes civile:

Rekomandime lidhur me aftësimin e punonjësëve të gjendjes civile dhe institucioneve shëndetësore;

1. Trajnim i personelit për zbatimin e procedurave në ofrimin e shërbimeve duke respektuar detyrimet e administratës shtetërore për të ofruar ndihmë ligjore në formë të informacionit ligjor dhe për t'u dhënë mundësinë shtetasve të realizojnë të drejtën e ankimit ndaj vendimeve të tyre në rastet që i vlerësojnë të pabazuara në ligj.
2. Trajnim i personelit mbi etikën dhe deontologjinë. Standartet e komunikimit në ofrimin e shërbimit ndaj publikut (në veçanti me njerëzit në nevojë).
3. Trajnim i personelit të institucioneve shëndetësore që asis-

tojnë lindjet, lidhur me mënyrën e plotësimit e të dokumentacionit përkatës (procesverbalit dhe certifikatës së asistencës në lindje).

Rekomandime lidhur me kushtet e ofrimit të shërbimit në gjendje civile;

1. Përmirësimi i mjediseve në të cilat ofrohet shërbimi, duke u mundësuar qytetarëve qëndrimin në ambjente me ajrosje të përshtashme, ngrohje/aspirim duke evituar agjentët atmosferikë –shi, diell, i ftohtë.
2. Shtimin e sporteleve të shërbimit, organizimin e shërbimit duke respektuar kohën, përmes paisjes me bileta dhe numra për paraqitjen me rradhë të qytetarëve.

Rekomandime për lehtësimin e procedurave për shtetasit shqiptar që banojnë jashtë Shqipërisë.

1. Të institucionalizohen procedurat përmes investimit të Ministrisë së Jashtme Shqiptare,

e cila të ketë autoritetin dhe përgjegjësinë për pranimin e kërkesave dhe dokumentave që disponohen në mënyrë të pjesshme nga qytetarët që i kanë lindur fëmijët jashtë shtetit, kundrejt tarifave apo pagesave të kalkuluara dhe të angazhojë konsullatat me legalizimin e tyre në përputhje me shkallët procedurale.

2. Të informohen shtetasit shqiptarë që banojnë jashtë Shqipërisë (veçanërisht në vendet fqinje ku është më i lartë numri i emigrantëve) nga vetë ambasadat dhe zyrat konsullore shqiptare, apo pranë pikave kufitare mbi kërkesat e ligjit për regjistrimin e lindjeve dhe

formën mbi vlefshmërinë e dokumentave të shteteve të huaja për tu përdorur në Shqipëri.

Rekomandime të tjera.

1. Të ju sugjerohet mospërdorimi i mjeteve të presionit të tërthortë (pagim taksash) si kusht për ofrimin e shërbimeve të gjendjes civile.

2. Të ju sugjerohet zyrtarëve të administratës shtetërore që të realizojnë identifikimin e personave që u kërkojnë shërbimet në mënyrë lehtësuese (siç mund të jetë fotokopjimi i dokumentit të identifikimit) duke mos kërkuar për çdo rast depozitimin e certifikatës së lindjes.



**Si mund të aplikoni për
tu trajtuar me strehim
në bazë të ligjit
9232/13.05.2004**

Aplikimi për t'u trajtuar me strehim, kryhet nëpërmjet një formulari që mund të tërhiqet në Zyrën e Informimit me Qytetarët, pranë Bashkisë së Tiranës ose në Njësitë Bashkiake, ku qytetari figuron i regjistruar. Ky formular duhet të plotësohet me vërtetësi në të gjitha fushat ku plotësohet dhe më pas të noterizohet. Më pas, Njësia Bashkiake përkatëse i përcjell këta formularë pranë Drejtorisë së Strehimit Social në Bashkinë e Tiranës, ku edhe regjistrohen në database-n elektronik të drejtorisë.

Nëpërmjet këtij sistemi, Bashkia e Tiranës ka mundur lehtësimin për administrimin e kërkesave për strehim social dhe ofrimin e një shërbimi cilësor, sasior dhe të përpunuar për qytetarët të Tiranës, me anën e të cilit mund të manaxhohet në mënyrë të infor-

matizuar programet e strehimit social gjatë gjithë procesit të tyre administrativ. Në veçanti, programi bën të mundur arkivimin e të dhënave, duke filluar nga kërkesat e paraqitura gjatë vitit 2005 e në vazhdim, leximin individual dhe të përbashkët të të dhënave, menaxhimin e dokumentave plotësuese, aplikimin e sistemit të pikëzimit, formimin e listave të përfituesve.

Bashkia e Tiranës është në fazën e grumbullimit, administrimit dhe regjistrimit të këtyre formularëve të strehimit me qëllim rikategorizimin e të pastrehëve në qytetin e Tiranës.



Aktualisht, në Tiranë, për periudhën dhjetor 2005 – Maj 2007 janë plotësuar nga ana e qytetarëve rreth 3.000 formularë. Qytetarët e Tiranës, të cilët kërkojnë të trajtohen me një nga programet sociale të parashikuara në këtë ligj do të vazhdojnë të aplikojnë, pasi ky proces mbetet i hapur. Bazuar në kuadrin ligjor të mësipërm, me Vendim të Këshillit Bashkiak Nr.63, datë 18.11.2005, Tirana ka ngritur një Komision Strehimi si organ këshillimor, për të gjitha problemet dhe veçanitë që paraqet kjo fushë.



Kriteret që duhet të plotësohen për tu klasifikuar për t'u trajtuar me programet sociale të strehimit

Kriteret që duhet të plotësohen për t'u klasifikuar, për t'u trajtuar me programet sociale të strehimit

Familjet, të cilat me Vendim të Këshillit Bashkiak klasifikohen për t'u trajtuar me një nga programet sociale të strehimit janë familjet që:

- a) Nuk kanë në pronësi një banesë;
- b) Zotërojnë sipërfaqe banimi nën normat e strehimit të përcaktuara për atë kategori sociale dhe ekonomike, ku bëjnë pjesë këto familje;
- c) Kanë mbetur të pastreha si rezultat i fatkeqësive natyrore; Përfshihen në një nga shkronjat "a", "b", "c", vetëm ato familje që kanë të ardhura të pamjaftueshme.

Kriteret e përzgjedhjes së përfituesve (përparësitë)

Kanë përparësi individët dhe familjet që klasifikohen për t'u trajtuar me programet sociale, të miratuara me Vendim të Këshillit Bashkiak dhe që kanë këto specifika:

1) Familjet, të cilat vërtetojnë se nuk kanë përfituar nga Ligji nr. 7652 datë 23.12.1992 "Për privatizimin e banesave shtetërore";

2) Familjet, ku kryefamiljari është grua e ve ose e divorcuar;

3) Familjet njëprindërore që kanë në ngarkim fëmijë;

4) Të moshuar, që kanë mbushur moshën e pensionit dhe që nuk përzgjidhen për t'u strehuar në institucionet publike të përkujdesit shoqëror;

5) Individët me aftësi të kufizuar, të cilët gëzojnë statusin e të verbrit të grupit të parë, të invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik, të invalidit të punës dhe të invalidit

të Luftës Nacionalçlirimtare;

6) Familjet me shumë fëmijë;

7) Çiftet e reja me moshë totale deri në 55 vjeç;

8) Familjet që kanë ndryshuar vend banim për efekt punësimi;

9) Individët me statusin e jetimit që nga çasti i daljes nga jetimoret ose nga qendrat e përkujdesit e deri në moshën 30 vjeç.

Elvira Dervishi
Këshilltare Programi, TLAS



Histori e vërtetë

Pranë Zyrës tonë u paraqit një klient i cili jetonte në qytetin e Tiranës me initiale H.L. Pasi kishte marrë dijeni për shërbimet që kryente zyra jonë nëpërmjet personave të tjerë, ai u paraqit duke kërkuar konsulencë ligjore për mbesat e tij të cilat ishin braktisur nga nëna e tyre për një periudhë të gjatë kohe.

Pasi u krye një intervistë me të u identifikuan problemet e tij. Nga intervista u konstatua se klienti H.L ishte gjyshi i dy fëmijëve të

mitur A.L dhe K.L të cilët kishin lindur nga martesja e djalit të tij me shtetasen M.L. Në vitin 2008 djali i tij kishte vdekur duke lene gruan dhe dy fëmijët A.L dhe K.L. Shtetasja M.L që në momentin që ka vdekur bashkëshorti i saj i ka braktisur femijet duke u larguar nga shtëpia dhe duke ia lene gjyshërve per tu kujdesur per mirërritjen e fëmijëve.

Shtetësja M.L për një periudhë të gjatë kohe ka treguar një mosinteresim të gjatë për dy fëmijët e saj duke mos plotësuar asnjë nga detyrimet qoftë edhe morale, të paktën për ti krijuar fëmijëve një ambient të qetë për tu rritur dhe për të krijuar me ta marrëdhënie të qëndrueshme prindërore.

U paraqit çështja në mbledhjen e radhës së Zyrës dhe nga diskutimet u arrit në përfundimin se kjo çështje mund të ndiqej nga avokatet e zyrës tonë duke marrë përsipër përgatitjen e të gjithë dokumentave të nevojshëm dhe ndjekjen e procesit gjyqësor deri në zgjidhjen përfundimtare të tij.



U shqyrtua rasti dhe u mendua që të përpilohej një padi me objekt "heqjen e përgjegjësisë prindërore të shtetasës M.L dhe caktimin si kujdestar të fëmijëve gjyshërit e tyre duke pasur parasysh mosinteresimin për një kohë të gjatë të nënës së tyre dhe marrëdhëniet e mira që fëmijët kanë me gjyshërit e tyre dhe faktori kryesor duke qenë se gjyshërit janë të vetmit persona të afërm të familjes që janë kujdesur gjatë gjithë kohës".

Neni 228 i Kodit të Familjes shprehet se "Kur prindi shpërdoron përgjegjësinë prindërore ose tregon pakujdesi të rëndësishme në ushtrimin e saj, ose me veprimet e tij ndikon në mënyrë të dëmshme në edukimin e fëmijëve, me kërkesën e prindit tjetër, të afërmit të fëmijës ose të prokurorit, mund t'i hiqet përgjegjësia prindërore.

Heqja e përgjegjësisë prindërore bëhet me vendim të gjykatës, duke u thirrur si i paditur prindi, për të cilin kërkohet kjo heqje.". Në rastin e shtetasës M.L ishte shpërdoruar në mënyrë të

përsëritur përgjegjësia e saj prindërore duke treguar pakujdesi të rëndësishme në ushtrimin e saj. Megjithatë ligjvënësi ka parashikuar se personit të cilit i hiqet përgjegjësia prindërore mund t'i kthehet në çdo moment kur ka pushuar shkaku për të cilin kjo përgjegjësi është hequr.

Ky moment është mjaft i rëndësishëm për të kuptuar pikërisht faktin se marrëdhënit prind fëmijë janë mjaft të rëndësishme dhe janë baza e familjes.

Gjithmone heqja e përgjegjësisë prindërore shoqërohet me caktimin e një kujdestari, në rastin konkret duke qenë se babai i





lencë të vazhdueshme. Gjykata arriti në përfundimin se klienti H.L kishte të drejtë në kërkimin e tij duke i dhënë në këtë mënyrë të drejtën për të qenë kujdestar i fëmijëve A.L dhe K.L.

Vlen të theksohet fakti se pavarësisht se nënës së fëmijëve iu hoq e drejta prindërore ajo mund ti takonte fëmijët në çdo moment që ajo e shihte të arsyeshme për të krijuar përsëri një marrëdhënie normale me ta.

Adrian Shega
Avokat/Keshilltar paraligjor
TLAS

fëmijëve kishte vdekur dhe nëna si e vetme kujdestare e fëmijëve i kishte braktisur personat më të afërt të familjes ishin gjyshërit që ishin kujdesuar vazhdimisht për fëmijët.

U depozitua kërkesë padia në gjykatë dhe u procedua me hapat e mëtejshëm, ku u zhvilluan disa seanca gjyqësore, gjatë kësaj kohe vazhdimisht çështja u ndoq nga avokati i caktuar duke përgatitur dokumentacionin ligjor në lidhje me çështjen dhe duke dhënë konsu-

Histori e vërtetë

Gj. C. është i burgosur në një burg të sigurisë së lartë, sepse vuan dënimin për vrasjen e bashkëshortes së tij, V. C., nënë e gjashtë fëmijëve. Kur ai morri vesh për aktivitetin e Shërbimit Ligjor Falas (TLAS), dërgoi një letër, ku kërkonte ndihmën tonë për realizimin e dy shërbimeve ligjore për të cilat ai kishte nevojë. Njëri problem kishte të bënte me faktin që në fletën e tij familjare të gjëndjes civile, figuronte ende gjallë ish bashkëshortja e tij. Gjithashtu dhe nuk ishte regjistruar në gjëndjen civile fëmija i tij i fundit. V. C. vazhdonte të figuronte në gjëndjen civile, sepse meqë vdekja e saj nuk ishte raportuar nga familjarët brenda afatit ligjor të 10 ditëve, në bazë të ligjit të gjëndjes civile, ky fakt duhet vërtetuar nëpërmjet gjykatës.

Në një komunikim me Gj. C., TLAS morri përsipër të realizonte këto dy regjistrime të gjëndjes civile, duke siguruar avokat falas. Fillimisht duhej filluar me vërtetimin



e faktit të vdekjes të V. C. Në përpjekje për grumbullimin e të dhënave të nevojshme për gjykatë, si dhe të çertifikatave të gjëndjes civile, TLAS kontaktoi me zyrat e gjëndjes civile të Prefekturës Fier, Nënprefekturës Lushnjë dhe të komunës, ku është e regjistruar familja e Gj. C. Mbase morrëm të dhëna edhe për prindërit e V. C. dhe kontaktuam me ta, mësuam që ata nuk ishin të gatshëm të bënin ndonjë veprim për regjistrimin e vdekjes së vajzës së tyre.



Krahas punës për kontaktimin e familjarëve të V. C., TLAS filloi grumbullimin e dokumentacionit të nevojshëm për në gjykatë.

TLAS bëri përcapje për të kontaktuar Gj. C. në burg, për të marrë një prokurë përfaqësimi nga ana e tij. Mbas shume përpjekjesh për të nxjerrë një lejë vizite në burgun e sigurisë së lartë dhe pas sorrollatjeve të shumta me kërkesa me shkrim dhe përcjellje nga njëri institucion shtetëror në tjetrin, vendosëm të kontaktojmë me

fëmijët madhorë të Gj. C. Sipas ligjit, kërkesën për regjistrimin e vdekjes së V. C. mund ta bënin edhe fëmijët e saj madhorë. Djali i madh jeton jashtë shtetit, ndërsa i dyti kryen shërbimin ushtarak. TLAS morri informacion për vendndodhjen e djalit të tij, E. C. dhe mbas takimit me të, u bë gati kërkesa për në gjykatë dhe prokura e përfaqësimit.

TLAS tashmë e ka depozituar kërkesën në gjykatë dhe kanë filluar seancat e para të shqyrtimit të çështjes. Jemi në pritje të mbarimit të shpejtë të gjykimit. Mbas regjistrimit të vdekjes së V. C., TLAS do fillojë nga puna për regjistrimin e faktit të lindjes së fëmijës së paregjistruar ende të familjes C., sepse ky fëmijë ka lindur në kushte shtëpie, kështu që edhe lindja e tij do të realizohet përmes një procedure gjyqësore.

Elvira Dervishi
Këshilltare Programi, TLAS

Histori e vërtetë

Klienti FQ u paraqit pranë zyrës së TLAS disa muaj më parë. Ai kërkonte ndihmë ligjore prej avokatëve të TLAS për t'ju drejtuar Gjykatës së të Drejtave të Njeriut në Strasburg, Francë. Përse mendonte se duhej t'i drejtohej Gjykatës së Strasburgut, cfarë kishte ndodhur dhe cfarë hapash kishte ndërmarrë deri në atë moment, përse kërkonte shërbim ligjor falas? Përgjigjet e këtyre pyetjeve treguan se:

Klienti FQ ishte martuar në vitin 1993 me bashkëshorten LQ, me të cilën lindi një djalë pas një viti martesë, më 1994. Ndodhi që në fillim të vitit 2000 gruaja e FQ diagnostikohet me sëmundje të rëndë dhe të pashërveshme. Sëmundja përkëqesohet dhe bashkëshortët vendosin që gruaja të shkojë për kurim në Itali, duke marrë me vete edhe djalë të tyre. LQ fillon kurimin në një spital afër vendbanimit ku aktualisht jetonin dy motrat dhe vëllai i saj. Klienti FQ gjithashtu i gjëndet pranë bashkëshortes së

tij në Janar 2001, duke udhëtuar drejt Italisë ashtu si kishte udhëtuar edhe e shoja me djalë të tij, me dokumenta jo të rregullta.

Ndërkohë bashkëshortja e FQ, përkëqesohet dhe vdes. Ai qëndron në Itali nga janari deri në gusht të 2002 dhe kthehet në Shqipëri për shkak të mosmarrëveshjeve me të afërmit e gruas së tij si dhe nga problemet me Kuesturën Italiane për shkak të mungesës së dokumentave të rregullta për qëndrim në Itali.



Por nderkohe femija i tij, djali vazhdon të qendrojë dhe jetojë ende me motrat dhe vëllain e gruas së tij në Itali.

Në vitin 2003 klienti FQ i drejtohet Gjykatës së Rrethit Gjyqësor në Shqipëri me kërkesë padi me objekt "Marrja e padrejtë e femijës në bazë të nenit 127 të Kodit Penal Shqiptar". Kjo padi ngrihet ndaj të pandehurve, motrave dhe vëllait të gruas së tij, LQ. Gjykata vendosi "Të deklarojë fajtorë të pandehurit e mësipërm për veprën penale të marrjes në mënyrë të padrejtë

të fëmijës në bazë të nenit 127 të Kodit Penal, të cilët dënohen me gjobë" Gjate zhvillimit të këtij procesi gjyqësor klienti vihet në dijeni se në Gjykatën e të Miturve të qytetit italian është ndërmarrë një proces ndaj femijës së tij. Kunata e klientit FQ, në vitin 2002 i drejtohet Gjykatës së të Miturve në Itali, për të kërkuar caktimin e kujdestarisë për nipin e saj jetim, të cilin ajo e mbante e ushqente dhe kujdesej për të. Gjykata vendos heqjen e autoritetit prindëror të babait që nuk jetonte pranë të birit dhe ja jep kujdestarinë për djalin kërkuar, tezes së tij.



Zyra e Prokurorisë së Përgjithshme në Shqipëri, Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë i drejtohet Misionit të Policisë Italiane në Shqipëri (Interforza), Tirane, pas shqyrtimit të deklarimeve të FQ, drejtuar kësaj zyre dhe paraqitjes së të gjitha dokumentave, për të njohur gjëndjen aktuale të fëmijës si dhe për të bërë të mundur riatdhësimin e tij si dhe për t'i dhënë fund një "adoptioni" të paligjshëm.

Ministria e Brëndshme Italiane bazuar në kërkesat e Prokurorisë së Përgjithshme Shqiptare, dërgon përmes një letre informacion të plot rreth kujdestarit të ligjshëm të fëmijës, kumatës së FQ si dhe djalit të tij.

Por në të njëjtën kohë klienti FQ, i drejtohet përsëri Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, duke thirrur në gjykim si palë paditëse kumatërit e tij, nëpërmjet një padije me objekt "Caktimi i mënyrës së takimit të paditësit me fëmijën, bazuar në nenin 225 të Kodit të Familjes". Gjykata mori vendimin "pranimi i padisë të paditësit duke e detyruar të paditurën, të lejojë takimin e tij me fëmijën." Për zbatimin e këtij vendimi Gjykata e Shkallës së Rrethit Gjyqësor lëshoi urdhër ekzekutimi në lidhje me zbatimin e vendimit civil, lidhur me urdhërimin e Zyrës së Përmbarimit, që të ekzekutojë në mënyrë të detyrueshme vendimin lidhur me të drejtën e takimit të klientit me fëmijën e tij.

Por sipas Vendimit të Gjykatës Italiane, të bazuar në kërkesën e kumatës së FQ, deklarohet se i



mituri banon ne Itali dhe Gjykata e të Miturve aty ka pezulluar të drejtën e prindit duke ia besuar fëmijën tezes së tij, nën kujdesin e Shërbimit Social të Komunës, duke shpallur tutor Kryebashkiakun e kësaj komune.

Në gjyqin e zhvilluar në shtetin italian, klienti nuk u përfshi në asnjë moment të zhvillimit të gjykit, nuk ka marrë asnjëherë njoftim dhe rrjedhimisht pa patur dijeni për vendimin e dhënë lidhur me fëmijën e tij. Autoritetet



Italiane nuk kanë arritur të realizojnë përfshirjen e ligjshme të klientit FQ në procesin gjyqësor, në të cilën ai duhet të ishte i pranishëm sepse gjykimi zhvillohej për kujdestarinë ndaj djalit të tij.

Klienti FQ ka adresuar mjaft kërkesa të tjera përfshirë gjykatat, zyrat e prokurorisë, të autoriteteve Italiane, por deri më sot nuk ka marrë asnjë përgjigje prej tyre. Për shkak të ngjarjeve të përshkruara më lart, klienti FQ u paraqit në zyrën


e TLAS dhe kërkoi ndihmë ligjore për hartimin e kërkesës drejtuar Gjykatës së të Drejtave të Njeriut në Strasburg, Francë. Kërkesa drejtuar kësaj gjykate bazohet në shkeljet e të drejtave të FQ, të shkaktuara prej autoriteteve përkatëse të shtetit italian. FQ ka paraqitur pretendimin për shkelje të nenit 6 Konventës së Mbrojtjes së të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, për shkelje të së drejtës së tij për një proces të rregullt gjyqësor .

Pra në vitin 2002, motra e gruas së FQ i drejtohet Gjykatës për të Miturit me pretendimin që nipi minorent t'i besohet asaj. Hetimi gjyqësor del me vendimin se kunata e tij është e përshtatshme për të zbatuar funksionet e kujdestarisë ndaj nipit, nën Vëzhgimin e Shërbimit Social të Komunës. Kjo kujdestari konsiderohet në interes të të miturit, pasi ai sipas vendimit të gjykatës, jetonte në gjëndje të pasigurtë dhe në rrezik, situatë në të cilën do të gjëndeje përsëri nëse do të dërgohej në Shqipëri.

Rezulton se Gjykata e të Miturve në Itali nuk ka ndërmarrë hetimet e plota paraprake për të përcaktuar drejtësisht këtë fakt. Në asnjë moment klienti FQ nuk është kontaktuar prej autoritetit të mësipërm, për t'u përfshirë në këtë proces vlerësimi të situatës familjare të fëmijës. Është e pakuptueshme sesi Gjykata ka arritur në përfundimin se "I mituri jetonte në gjendje të pasigurtë dhe në rrezik dhe në të cilën do të gjëndej përsëri nëse do të dërgohej në Shqipëri".

Sipas këtij vendimi prindërit nuk janë të përshtatshëm për ushtrimin e plotë të autoritetit prindëror, duke u larguar ai e lejuar të miturin , pa u kujdesur për mundimet që i biri do të duhej të përballonte dhe prandaj është e mundur të pezullohet autoriteti i tyre, për më tepër në kushtet kur nuk janë të pranishëm në territorin ku minoren jeton.

Klienti FQ, si babai i fëmijes e ka shumë të paqartë situatën sesi prokurori ka përcaktuar "përshtatshmërinë për ushtrimin e



saktë të autoritetit prindëror", kur ai nuk ka vendosur fare kontakte me të. Vlerësimi i autoriteteve prindërore është bërë në mënyrë të njëanshme dhe vendimi i gjykatës është bazuar vetëm në ato çfarë mund të jenë deklaruar apo paraqitur si prova prej kumatës së tij, duke mos realizuar asnjë lloj forme njoftimi për zhvillimin e procesit gjyqësor.

Gjykata vendos heqjen e autoritetit prindëror, duke i dhënë kujdestarinë e të miturit tezes së tij nën vëzhgimin e Shërbimit So-

cial të Komunës, një institucion që do të sigurojë kryerjen e të gjitha ndërhyrjeve të nevojshme për mbrojtjen e të miturit, pra deklarën pezullimin e autoritetit prindëror mbi vetë të miturin. Po sipas këtij vendimi, Shërbimi Social Ndërkombëtar duhet të bëjë hetime mbi gjëndjen familjare të të miturit në vendin e origjinës. Që nga moment i vendimit të formës së prerë të nxjerrë nga Gjykata Italiane e deri më sot, klienti FQ nuk ka marrë asnjë lajmërim ose njoftim apo kontakt prej autoriteteve Italiane, përfshirë edhe Shërbimin

Social Ndërkombëtar.

Pretendimi i klienti bazohet në shkeljen e nenit 6 të KEDNJ, që parashikon se e drejta për një proces të rregullt, shpreh të drejtën e çdo personi që “çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar ligjërisht, e cila do të vendosë ... për mosmarrëveshjet mbi të drejtat dhe detyrimet e tij me karakter civil....Vendimi duhet të jepet publikisht....”.

FQ informohet për ekzistencën e një vendimi të Gjykatës së të Miturve në Itali vetëm rastësisht gjatë zhvillimit të procesit gjyqësor në Shqipëri, pasi klienti iu drejtua Zyrës së Prokurorisë së Përgjithshme në Shqipëri, e cila pas kontakteve me autoritetet Italiane nëpërmjet Ministrisë së Drejtësisë, informohet nga Drejtoria e Përgjithshme për Ndërhjet e Drejtësisë Minorene dhe Kryerjes së Masave Gjyqësore Italiane për ekzistencën e vendimit të përmendur më sipër të marrë nga Gjykata Italiane për



të miturit. FQ i është mohuar e drejta e aksesit në këtë proces gjyqësor, duke iu mohuar e drejta për t'u dëgjuar në këtë gjykatë, fakt i cili ka sjelle një ndikim të drejtëpërdrejtë mbi të drejtat dhe detyrimet e tij si prind.

Ne vijim të kësaj, duket se për klientin FQ nuk është respektuar edhe neni 8 i Konventës, e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare, duke i hequr kujdestarinë pa qënë fare i pranishëm në gjykim, pra autoritetet italiane kanë vendosur në mënyrë të njëanshme caktimin e kujdestarisë së fëmijës së tij. Nga ky fakt rrjedh dhe cënimi i marrëdhënieve familjare të paditësit në lidhje me fëmijën. A ka vepruar kjo Gjykatë në bazë të interesit më të lartë të fëmijës?

Po t'i referohemi rastit GÖRGÜLÜ v. Gjermani, të gjykatës së Strasburgut ku thuhet se "gjykata shkeli të drejtën e babait duke shkelur kështu të drejtën e jetës familjare, përmes ndalimit të babait për të jetuar me fëmijën



e tij edhe pse babai kishte akses te djali i tij, edhe pse mundësia apo dëshira e babait për t'u kujdesur për fëmijën nuk u diskutuan".

Sipas vendimeve të mëparshme të Gjykatës së Strasburgut në rastin e cituar më sipër apo në atë të Kroon and Others v. Ho-llandë, theksohet se për ekzistencën e lidhjeve familjare që duhen vendosur me një fëmijë, shteti duhet të veprojë në mënyrë që të mundësojë këtë lidhje". Pra, duke vazhduar citimin e Gjykatës për këtë rast

theksojmë: “Neni 8 i Konventës Për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut u imponon shteteve detyrimin për të ribashkuar një prind natyral me fëmijën e tij”.

Gjykata italiane e të Miturve në Itali nuk ka marrë përsipër këtë fakt duke cënuar të drejtën e tij si prind për të qënë i pranishëm në një proces gjyqësor në interes të fëmijes së tij dhe duke marrë një vendim në mungesë të një hetimi paraprak e të plotë gjyqësor.

Përpjekjet e klientit vërtetojnë se ai nuk ka asnjë kontakt me fëmijën që prej ditës që u ai largua nga Italia në gusht të vitit 2000, moment që u dëbua prej autoriteteve policore italiane për shkak të mungesës së dokumentave të ligjshme të qëndrimit atje. Ai i është adresuar autoriteteve italiane me shkrim për të kërkuar takim me djalin dhe të afërmit e gruas por ata nuk i kane kthyer asnjë përgjigje në asnjë formë.

Në rastin e Klientit tonë konstatohet shkelje e Nenit 6 dhe 8 të

KEDNJ nga autoritetet Italiane, të cilët janë përgjegjës për mosrespektim të tyre sic është përkthyer më sipër. Shteti Italian është përgjegjës gjithashtu dhe për dëmin moral të shkaktuar te babai që në mënyrë flagrante është zhveshur padrejtësisht nga kujdestaria dhe e drejta prindërore. FQ si babai i fëmijës është i shqetësuar edhe për pasojat që i janë shkaktuar në kushtet e mungesës së pranisë dhe dashurisë prindërore në kushtet edhe të humbjes së nënës.

TLAS i konsideroi të drejta pretendimet e klientit duke evidentuar shkelje të KEDNJ të ratifikuar prej shtetit shqiptar dhe e bërë pjesë e ligjit tonë. Për këtë arsye klientit iu pregatit kërkesa drejtuar Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut në Strasburg. TLAS është në pritje të korrespondencës me gjykatën.

Anisa Haxhiaj
Avokate/këshilltare paraligjore
TLAS

Histori e vërtetë

Pranë Zyrës tonë u paraqit një klient i cili jetonte në qytetin e Tiranës me initiale N.V. Pasi kishte marrë dijeni për shërbimet që kryente zyra jonë nëpërmjet personave të tjerë, ai u paraqit duke kërkuar konsulencë ligjore për problemin e tij i cili konsistonte në gabimin që ishte bërë në regjistrimin e datës së lindjes së tij.

Pasi u krye një intervistë me të u identifikuan problemet e tij. Nga intervista u konstatua se klienti N.V për një periudhë të gjatë kohe kishte jetuar në qytetin e Mirditës ku edhe kishte lindur. Para 5 vjetësh kishte transferuar gjëndjen civile nga qyteti i Mirditës drejt qytetit të Tiranës. Pasi ishte transferuar në qytetin e Tiranës ishte drejtuar në Zyrat e Gjëndjes Civile për tu pajisur me certifikatë të cilën do ta përdorte për të marrë pashaportë. Në momentin që ishte paraqitur në gjëndjen civile kishte konstatuar se data e lindjes së tij nuk korrespondonte me datën në të



cilën ai kishte lindur, pasi të gjithë dokumentat që ai dispononte që nga fëmijëria dhe të gjithë dokumentat e tjerë të shkollës dhe të punës ishin me datën në të cilën ai kishte lindur.

Nderkohe që në aktin e lindjes i ishte regjistruar si datë lindjeje një datë tjetër.

U paraqit çështja në mbledhjen e radhës së Zyrës dhe nga diskutimet u arrit në përfundimin se kjo çështje mund të ndiqej nga avokatet e zyrës tonë por vetëm përsa i përket përpilimit të dokumentave të nevojshëm për gjyq dhe të gjithë dokumentave të



tjerë që do të kërkoheshin nga gjykata gjatë zhvillimit të procesit. Vete ky proces kishte një specifikë pasi gjykimi nuk mund të zhvillohej në qytetin e Tiranës por duhet të zhvillohej në qytetin në të cilin ishte mbajtur akti i lindjes para 50 vjetësh, pra në qytetin e Mirditës.

U shqyrtua rasti dhe u mendua që të përpilohej një padi me objekt "Deklarimi i pasaktësisë së rubrikës "datelindja" e aktit të lindjes së klientit N.V, përse i përket rubrikës së datës së lindjes". Klienti N.V pretendonte se deklarimi nga ana e te afërmve për lindjen e tij ishte bërë i saktë por

punonjësit e gjëndjes civile kryesisht nga neglizhenca e kishin lënë pas dore duke mos i kryer të gjitha procedurat në momentin e deklarimit por në një moment të mëvonshëm duke sjellë edhe gabimin në rubrikën e datëlindjes.

Neni 39/3 i ligjit "Per Gjendjen Civile" shprehet se "Shtetasi, përfaqësuesi ligjor ose kujdestari, si dhe çdo person tjetër që pretendon se i është cenuar një e drejte ose është privuar nga pasoja juridike të caktuara, pretendimet për pavlefshmëri, pasaktësi e falsitet mund t'i parashtrojnë vetëm gjyqesisht, duke thirrur si të paditur zyrën e gjendjes civile, ku është mbajtur akti dhe deklaruesin, kur nuk është vete paditës."

Në këtë rast pretendimet e klientit N.V për pasaktësi vërtetoheshin plotësisht pasi të gjithë dokumentat që ai dispononte kishin datëlindjen e saktë të tij.

U depozitua kërkesë padia në gjykatë dhe u procedua me ha-

pat e mëtëjshëm, ku u zhvilluan disa seanca gjyqësore, gjatë kësaj kohe vazhdimisht çështja u ndoq nga avokati i caktuar duke përgatitur dokumentacionin ligjor në lidhje me çështjen dhe duke dhënë konsulencë të vazhdueshme për çështjen. Gjykatë arriti në përfundimin se klienti N.V kishte të drejtë në kërkimin e tij duke i njohur në këtë mënyrë të drejtën e tij për të korrigjuar pasaktësitë e bëra në aktin e lindjes së mbajtur në qytetin e Mirditës.

Mbas një pune të gjatë duke vlerësuar dhe kontributin e madh të Zyrës për Shërbimin Ligjor Falas u arrit në përfundimin e dëshiruar nga klienti N.V.

Adrian Shega
Avokat/Keshilltar paraligjor
TLAS



Shërbimi Ligjor Falas Tiranë

Nr. 2 / 2009

TLAS

